



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS, ZGJEDHJET
PËR KUVENDIN KOMUNAL DHE ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË KOMUNËS - 2007

NËSE NUK I GJENI KËTO TË DHËNA, MUND TË NDODHË QË REGJISTRI JUAJ CIVIL ËSHTË ENDE DUKE I FUTUR KËTO TË DHËNA, OSE QË NDRYSHIMI NUK ËSHTË PASQYRUAR ENDE NË LISTËN E VOTIMIT. NËSE MENDONI SE KJO ËSHTË GABIM, LUTENI TË OFRONI TË GJITHA HOLLËSITË TUAJA TE ZZK (NUMRIN E UNMIK-UT, MBIEMRIN, EMRIN, DATËN E LINDJES, ADRESËN, NUMRA TË TELEFONIT, ADRESËN ELEKTRONIKE, ...) DHE KQZ DO TË SHQYRTOJË KËTË.

ZZK

KY MEKANIZËM PËR KËRKIM PO ASHTU ËSHTË NË DISPOZICION NËPËR ZZK TË CILAT MUND TË U NDIHMOJNË TË GJENI QENDRËN TUAJ TË VOTIMIT. MOS NGURRONI TË SHTRONI ÇFARËDO PYETJE NË LIDHJE ME ZGJEDHJET NË ZZK TUAJ LOKALE.

NËSE KJO QENDËR NUK JU PËRSHTATET (SHUMË LARG, VOTONI NË VEND TJETËR NGA ANËTARËT E FAMILJES, ...) JU LEHTË MUND TË KALONI TEK NJË TJETËR QENDËR VOTIMI NË KOMUNËN E NJËJTË DUKE PLOTËSUAR FORMULARIN "KËRKESË PËR NDRYSHIM TË QENDRËS SË VOTIMIT".

NËSE DËSHIRONI TË VOTONI NË NDOJË QENDËR VOTIMI JASHTË KOMUNËS KU NDODHET QENDRA JUAJ AKTUALE, JU DUHET TË VIZITONI QKRC TUAJ LOKALE (PYESNI ZZK PËR ADRESË), DHE VETËM ATËHERË DO TË PASQYROHET NDRYSHIMI NË LISTËN E VOTUESVE.


MOS HARRONI, ZZK MUND TË NDRYSHOJË QENDRËN TUAJ TË VOTIMIT POR VETËM QKRC MUND TË NDRYSHOJË ADRESËN TUAJ.



ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS, ZGJEDHJET
PËR KUVENDIN KOMUNAL DHE ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË KOMUNËS - 2007

2007

NËSE KENI PYETJE TË TJERA LUTENI TË NDALENI DHE TË VIZITONI ZYRTARIN TUAJ KOMUNAL PËR ZGJEDHJE. ADRESËN E TYRE MUND TA GJENI NË FAQEN E INTERNETIT TË KQZ: WWW.CEC-KO.ORG



PËR ZGJEDHJET 2007 NË KOSOVË, KQZ ORGANIZON NJË PERIUdhË PËR SHËRBIM TË VOTUESVE NË TËRË KOSOVËN QË DO TË ZGJASË DERI ME 12 TETOR 2007. KJO SYNON QË T'U OFROJË VOTUESVE NËPËR KOSOVË MUNDËSINË PËR TA VERIFIKUAR QENDRËN E VOTIMIT TË CAKTUAR PËR TA DHE TË GJEJNË PËRGJIGJE NË PYETJET THELBËSORE:

- A KAM TË DREJTË TË VOTOJ?


- NË BAZË TË DOKUMENTACIONIT QË OFRONI, ZKK (ZYRA PËR ZGJEDHJE KOMUNALE) MUND T'U NDIHMOJË JUVE TË VLERËSONI SE A KENI TË DREJTË TË VOTONI. NËSE JENI REGJISTRUAR NË REGJISTRIN CIVIL DHE I KENI MBUSHUR 18 VJET NË DITËN E ZGJEDHJEVE, JU KENI TË DREJTË TË VOTONI. NËSE NUK JENI NË REGJISTRIN CIVIL, JU DUHET T'Ë PËRMBUSHNI DISA KRITERE PËRVEÇ MOSHËS DHE IDENTITETIT ME DOKUMENTE RELEVANTE. (SHIH DOKUMENT E BASHKANGJITURA NË ZKK).

- KU DUHET TË VOTOJ?

- ZKK MUND TË SHIKOJË TË DHËNAT TUAJA NË INTERNET PËRMES MEKANIZMIT PËR KËRKIM TË LISTËS SË VOTUESVE DHE DO TU TREGOJË JUVE VENDIN AKTUAL TË QENDRËS SUAJ TË VOTIMIT. MADJE KËTË MUND TA KONTROLLONI EDHE VET NË NDONJË INTERNET KAFE OSE NË SHTËPI PA U MUNDUAR FARE.

- SI I FRESKOJ TË DHËNAT E MIA?

- NËSE DËSHIRONI TË NDRYSHONI QENDRËN TUAJ TË VOTIMIT, VETËM PLOTËSOJENI FORMULARIN PËR "NDËRRIM TË QENDRËS SË VOTIMIT" ME NDIHMËN E ZKK SUAJ LOKALE. KJO VLEN VETËM NËSE NDËRRONI QENDRËN E VOTIMIT BRENDA KOMUNËS SË NJËJTË.
- NËSE KENI NDËRRUAR VENDBANIMIN DHE DËSHIRONI TË VOTONI NË NJË QENDËR VOTIMI NË NDONJË KOMUNË TJETËR NGA AJO E VITIT 2004, JU DUHET TA INFORMONI QKRC (QENDRËN KOMUNALE TË REGJISTRIMIT CIVIL) PËR NDRYSHIMIN E ADRESËS SUAJ. ATËHERË



NDRYSHIMI DO TË PASQYROHET NË LISTËN E VOTUESVE. DUHET PATJETËR TA BËNI NDRYSHIMIN PARA 12 TETORIT.

INTERNETI

MEKANIZMI PËR KËRKIM I LISTËS SË VOTUESVE ËSHTË NË DISPOZICION PUBLIK NË INTERNET KU MUND TË VËRTETONI SE CILA ËSHTË QENDRA JUAJ E VOTIMIT. VETËM VIZITONI NDONJËRËN NGA FAQET NË VAZHDIM:

- <http://kosovoelections.org/ENG/VS/PCSearch.aspx?lang=en>
- <http://zgjedhjetekosoves.org/ALB/VS/PCSearch.aspx?lang=sq>
- <http://kosovskiiizbori.org/SRB/VS/PCSearch.aspx?lang=sr>

PLOTËSOJENI NUMRIN TUAJ TË UNMIK-UT OSE MBIEMRIN, EMRIN DHE DATËN E LINDJES DHE SHTYPNI "KËRKIM". ATËHERË DO TË PARAQITEN NË HOLLËSI TË DHËNAT TUAJA ME QENDRËN E VOTIMIT TUAJ DHE VENDNDODHJEN E SAJ.

2007

2007

2007